

# Memorandum i Mirëkuptimit mes Fondacioni i Mijëvjeçarit i Kosovës dhe Komunës së Lipjanit për Riparimet për Eficiencë të Energjisë në Ndërtesat Banesore (AER)

Data: 23 nëntor 2020

REPUBLICA E KOSOVES  
KOMUNA LIPJAN  
REPUBLIKA KOSOVO  
OPSTINA LIPLJAN

Pranuar më:	25. 11. 2020	
Primjano:		
Idësia Lidhëse	Matr. Shif.	Shifra Bashkë
01-352-57762		

Ky Memorandum i Mirëkuptimit ("MiM") lidhet nga dhe në mes të:

1. **Fondacionit të Mijëvjeçarit të Kosovës ("MFK")**, fondacion vendor i organizuar dhe regjistruar në bazë të Programit Threshold të Sfidës së Mijëvjeçarit-Marrëveshja për Grant ("Marrëveshja"), nënshkruar dhe ratifikuar më 12 shtator 2017, midis Republikës së Kosovës, të përfaqësuar nga Presidenti i Republikës të Kosovës ("Qeveria"), dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të përfaqësuar nga Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit (në tekstin e mëtejshëm ("MCC")); dhe

2. **Komuna e Lipjanit ("Komuna")**.

Më poshtë të referuara veçmas si "MFK" dhe "Komuna", dhe së bashku si "Pjesëmarrësit" në këtë MM.

## I. Përkufizimi

Në këtë MM, shprehjet e mëposhtme kanë kuptimin si vijon:

- **AER** Riparimet për Eficiencë të Energjisë në Ndërtesa Banesore
- **Kontraktor** Kompani e punëve ndërtimore, e përzgjedhur nga MFK përmes procedurës së tenderimit
- **DSC** Kompani e dizajnit dhe mbikëqyrjes, e përzgjedhur nga konsulenti implementues
- **EE** Eficienca e Energjisë
- **KI** Konsulenti Implementues i PIEE
- **MAB** Ndërtesë banesore për shumë familje
- **MCC** Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit
- **MFK** Fondacioni i Mijëvjeçarit të Kosovës
- **PIEE** Pilot stimujt për Eficiencë të Energjisë
- **RELP** Projekti i Peizazhit të Energjisë Eficiente
- **SEEK** Subvencionet për Eficiencën e Energjisë në Kosovë programi "Threshold" – do të thotë programi i përshkruar në Marrëveshjen për Grant të Programit "Threshold" mes MCC dhe Qeverisë së Kosovës më 12 shtator të vitit 2017.
- **GNE** Gratë Ndërmarrëse në Energji

## II. Historiku

Qeveria ka themeluar MFK-në si subjekt autonom me autoritet të pavarur ligjor për të mbikëqyrur, menaxhuar dhe zbatuar Marrëveshjen e Programit Threshold të financuar nga MCC. Programi Threshold me Republikën e Kosovës do të sigurojë deri në 49 milion dollarë për të mbështetur reforma të rëndësishme të politikave për të përmirësuar furnizimin me energji elektrike përmes promovimit të efikasitetit të energjisë dhe gjenerimit të energjisë së ripërtërishme, si dhe për të promovuar qeverisje transparente dhe të përgjegjshme.

RELP synon të zvogëloj hendekun mes kërkesës dhe ofertës për energji duke zvogëluar përdorimin e elektricitetit me pilot investime për eficiencë të energjisë në ekonomi familjare, duke kaluar në burime të ngrohjes me kosto efektive që nuk bazohen në energji elektrike si dhe duke zvogëluar e barrierat për hyrjen në treg të prodhuesve të pavarur të energjisë. **Pilot projekti për stimujt për Eficiencë të Energjisë (PIEE)**<sup>1</sup> në kuadër të RELP pritet të kontribuoj drejt arritjes së objektivit të RELP duke rritur ndërgjegjësimin e konsumatorëve në lidhje me masat për kursimin e energjisë dhe përfitimin prej tyre si dhe duke u mundësuar ekonomive familjare me të hyra më të ulëta të tejkalojnë pamundësinë e pagesës përmes ofrimit të stimujve. Projekti PIEE përbëhet nga tre (3) pako kryesore të intervenimit (PI): (i) Riparimet për eficiencës në ekonomi familjare (HER); (ii) Riparimet për eficiencë të energjisë në ndërtesa banesore (AER), dhe (iii) Gratë Ndërmarrëse në Energji (GNE). Asistenca teknike për MFK sa i përket zbatimit të PIEE ofrohet nga Konsulentit Implementues ("KI").

Objektivat kryesore të pakos së intervenimeve të AER janë zvogëlimi i kërkesës për energji/elektricitet dhe kostove të ndërlidhura në sektorin e banimit; rritja e ndërgjegjësimit për EE në sektorin e banimit; përmirësimi i konkurrencës në tregun e shërbimeve të energjisë në Kosovë; dhe mbështetja e standardeve të EE dhe programeve të stimujve për zhvillimin e mëtejshëm të ndërtesave shumë banesore (MAB).

Komuna e Lipjanit synon të ndërmarr hapa proaktiv në përfshirjen dhe forcimin e strukturave organizative që janë të përshtatshme për përmirësimin e masave të EE/BRE në kuadër të sektorit të banimit me një fokus në riparimet e eficiencës së energjisë për ekonomin familjare (HER) dhe Riparimet për efikasitet të ndërtesave banesore (AER). Komuna dhe KI kanë nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi (MM) më 17 dhjetor të vitit 2019 për të nxitur bashkëpunimin mes tyre dhe kontribuimit në arritjen e objektivave dhe zbatimin e aktiviteteve të planifikuara të PIEE-së.

PRANDAJ, në bazë të besimit dhe bashkëpunimit të ndërsjellët si dhe me qëllim të përkufizimit të mëtejshëm të hollësive të bashkëpunimit në lidhje me zbatimin e nën-projekteve të AER, pjesëmarrësit synojnë të lidhin këtë MM.

## III. Qëllimi

Qëllimi i këtij MM është të promovoj bashkëpunimin mes MFK dhe Komunës së Lipjanit për zbatimin e masave të eficiencës së energjisë në ndërtesat shumë-banesore ("Projekti" sipas këtij MM) si pjesë e Projektit më të madh të Peizazhit të Energjisë së Besueshme ("RELP") të implementuar nga MFK. Prandaj, MFK dhe Komuna kanë shprehur qëllimin e tyre që të zbatojnë projektin e ndërlidhur me ndërtesat shumë banesore ("MAB"). Duke nënshkruar këtë MM, pjesëmarrësit synojnë të ofrojnë mbështetje financiare për MAB e

përzgjedhura, si dhe në fazat e mëvonshme synojnë të hyjnë në një marrëveshje të veçantë që do të përcaktoj përqindjen (%) e saktë dhe hollësitë e bashkë-financimit për një financim të tillë.

#### **IV. Natyra e bashkëpunimit**

MFK dhe Komuna synojnë të bashkëpunojnë dhe të ofrojnë mbështetje financiare për intervenimet e ndërlidhura me AER për MAB-të e përzgjedhura. Plani i financimit fillestar të paraparë që është bashkëngjitur si Shtojca 1 në këtë MM, ofron një shumë të vlerësuar të mbështetjes financiare që synohet të ofrohet nga MFK dhe Komuna. Në mënyrë që aktivitetet e planifikuara të realizohen dhe për buxhetin që do të vihen në dispozicion të MFK dhe të Komunës për nën-projektet e AER, pjesëmarrësit në këtë MM ndajnë një qëndrim të përbashkët mbi një sërë pikash në lidhje me bashkëpunimin e tyre të ardhshëm për zbatimin e nën-projekteve të AER:

- (a.) MFK dhe Komuna synojnë të bashkëpunojnë dhe të ofrojnë asistencën dhe burimet e nevojshme për financimin e përbashkët për dy komplekset e përzgjedhura MAB më poshtë:
  - i. Kompleksi MAB nr.1: HOA "Sheshi"
  - ii. Kompleksi MAB nr. 2: HOA "Shpresa+Semafori"
- (b.) Komuna synon të sigurojë mbështetje financiare duke bashkë-financuar 30% të gjithëj kostos së nën-projektit plus Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) për secilin kompleks MAB (lot) të referuar në pikën e mësipërme a), ndërsa shumta e mbetur (70%) do të financohet nga MFK. Pritet që shumtat e sakta të bashkëfinancimit do të përcaktohen në një marrëveshje të veçantë midis Pjesëmarrësve, pasi që MFK të ketë siguruar kontraktuesin.
- (c.) Pritet që zbatimi i nën-projekteve të AER do bazohet në Dizajnimin e Hollësishëm Arkitektonik dhe Inxhinierik (DAED) të përgatitur nga Kompania e Dizajnit dhe Mbikëqyrjes (DSC) e kontraktuar nga KI në kuadër të aktivitetit PIEE.
- (d.) Secili nga pjesëmarrësit duhet të caktojë një pikë të vetme kontakti për këtë Memorandum të Mirëkuptimit dhe gjitha aktivitetet pasuese, në mënyrë që të sigurojë komunikim të lehtë gjatë zbatimit të nën-projekteve.
- (e.) Leja e ndërtimit (ose një deklaratë e përshtatshme që përcakton se nuk nevojitet) pritët të lëshohet nga Komuna si një çështje me prioritet të lartë dhe në kohën më të shkurtër të mundshme.
- (f.) MFK dhe Komuna synojnë të parandalojnë faktorët e mundshëm të rrezikut që mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e nën-projektit dhe aktivitetet e tyre dhe të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar zbatimin e suksesshëm të aktiviteteve të nën-projektit.

## V. Aktivitetet e përbashkëta

MFK dhe Komuna planifikojnë të ndjekin aktivitetet e mëposhtme për të përmirësuar aftësinë e tyre që të bashkëpunojnë:

- (a.) MFK dhe Komuna pritet të marrin pjesë në ceremoninë e nënshkrimit të këtij MM.
- (b.) MFK dhe Komuna synojnë të ofrojnë asistencën e nevojshme, përfshirë edhe shkëmbimin e informatave që janë të rëndësishme për zbatimin e aktiviteteve të nën-projekteve të AER.

MFK dhe Komuna synojnë të angazhohen në mënyrë proaktive në aktivitetet e përbashkëta të nën-projekteve të AER si dhe të monitorojnë implementimin e aktiviteteve dhe të bashkëpunojnë në identifikimin e zgjidhjeve në rast rreziku të dështimit të aktiviteteve.

## VI. Komunikimi dhe njoftimet


Për qëllimin e këtij MM, MFK dhe Komuna përfaqësohen nga personat që mbajnë ose veprojnë në pozitat e mëposhtme:

Secili prej pjesëmarrësve në këtë MM mund të propozojë përfaqësues të tjerë të autorizuar për të përfaqësuar pjesëmarrësin për të gjitha qëllimet e këtij MM, përveç për ndryshimin zyrtar të këtij MM. Secili pjesëmarrës duhet të njoftojë me shkrim për ndryshimet në lidhje me përfaqësimin e autorizuar sipas këtij MM.

**VII. Fillimi, ndryshimi dhe ndërprerja e këtij MM**

Pjesëmarrësit parashohin që aktivitetet në kuadër të këtij MM do të fillojnë në datën e nënshkrimit të tij nga të dy Pjesëmarrësit. MFK dhe Komuna mund të ndryshojnë ose ndërpresin këtë MM me shkrim në çdo kohë.

NË DËSHMI TË KËSAJ, MFK dhe Komuna duke vepruar përmes përfaqësuesve të tyre të autorizuar, e nënshkruajnë këtë MM në dy kopje origjinale në gjuhën angleze dhe shqipe më 23 nëntor të vitit 2020.



**Fondacionit të Mileniumit të Kosovës**

**Petrit Selimi**

Drejtor Ekzekutiv

Fondacioni i Mileniumit të Kosovës



**Komuna e Lipjanit**

**Imri Ahmeti**

Kryetar i Komunës



**SHTOJCA I****Plani Fillestar i Financimit**

Plani Fillestar i Financimit paraqet aranzhimet e pritshme financiare mes Pjesëmarrësve (MFK dhe Komuna e Lipjanit) për bashkë-financimit e riparimeve për EE të dy komplekseve të MAB në Lipjan, duke u bazuar në koston e investimeve të parapara përmes Dizajnit të hollësishëm arkitektural dhe inxhinierik (DAED) të përgatitur nga Kompania për Dizajnim dhe Mbikëqyrje (DSC) që është kontraktuar nga KI. DAED-ja është përgatitur duke u bazuar në dokumentacionin e outputeve të projektit të Bankës Botërore "Themelimi i HOA (gjatë periudhës 2016-2018)" ("Projekti i BB").

Projekti i BB ka adresuar dy komplekse të MAB. Njëri nga komplekset MAB përbëhet nga 3 MAB (përkatësisht 3 hyrjeve) dhe ka tashmë të themeluar Shoqatën e Pronarëve të Shtëpive (HOA) të emërtuar "Sheshi". Kompleksi tjetër MAB përbëhet nga 5 MAB dhe ka dy HOA të emërtuara "Shpresa and Semafori". Dokumentacioni i DAED e ndjek konceptin e projektit të BB dhe rrjedhimisht është në dispozicion për të tri HOA veçmas. Megjithatë, pritet që zbatimin e riparimeve do të përqendrohet në dy komplekset e MAB.

Duke u bazuar në DAED, kostoja totale për zbatimin e masave EE, fushëveprimi i të cilave është dakorduar mes MFK dhe Komunës është vlerësuar të jetë 712,799.05 euro (pa përfshirë TVSH-në). Pas kërkesës së Komunës së Lipjanit, kompleksi i MAB "Sheshi" përfshinë edhe disa masa dekorative që rrjedhimisht nuk janë masa të EE (mbulesa ballkoni) që nuk janë të pranueshme për bashkë-financim të PIËE (SEEK) nga MFK. Megjithatë, Komuna synon të financoj 100% të këtyre punëve shtesë. Shumat e vlerësuara të bashkë-financimit për MFK dhe Komunën janë të paraqitura në Tabelën 1 më poshtë.

Plani i prezantuar i financimit fillestar tregon versionin fillestar të një plani të tillë, i cili është bazuar në vlerësimet (më të mira) të përgatitura nga DCS. Kostoja e saktë e investimit në terma absolut (Euro) pritet të përkufizohet vetëm pasi MFK të ketë siguruar kompaninë ndërtuese (kontraktorin).

TABELA 1: Vlerësimi i koston për zbatimin e masave të EE në dy komplekse MAB në Lipjana	KOSTOJA TOTALE (PA TVSH)		NDARJA E GRANTIT (PA TVSH)		KOSTOJA TOTALE E INVESTIMEVE	
	MEE	Jo-MME	Komuna 30% + jo-MEE	MFK 70%	Komuna (me TVSH)	MFK (pa TVSH)
Kompleksi MAB nr.1 HOA: Sheshi	€ 334,132.50	€ 8,600.00	€ 108,839.75	€ 233,892.75	€ 128,430.91	€ 233,892.75
Kompleksi MAB nr. 2 HOA: Shpresa+Semafori	€ 390,534.00		€ 117,160.20	€ 273,373.80	€ 138,249.04	€ 273,373.80
	€ 724,666.50	€ 8,600.00	€ 225,999.95	€ 507,266.55	€ 266,679.94	€ 507,266.55
<b>TOTALI</b>	<b>€ 733,266.50</b>		<b>€ 733,266.50</b>		<b>€ 773,946.49</b>	